



Ne takimin midis Shqiperise dhe Greqise te luajtur ne stadiumin "Niko Dovana " ne Durres me ne fund Kombetarja shqiptare e femrave ka shenuar fitoren e pare në kuader te kualifikimeve "Kanada 2015". Pjesa e pare e kesaj sfide ka qene jo shume premtuese per te dyja skuadrat. Ne fillimin e pjeses se dyte Shqipëria arriti te guxonte me shume drejt drejt portes helene, dhe keto sulme dhane fryte në minutën e 51-te kur sulmuesja Fortuna Velaj arriti te shenonte nje gol spektakolar. Goli kuqezi beri qe helenet te mundoheshin te ndryshonin rezultatin por pa sukses. Shqiperia arriti fitoren e pare ne historine e shkurter te saj. Skuadra Shqiptare mban vendin e parafundit duke e lene prapa vetem Greqine.